

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-253/13

**Prishtinë,
6 May 2015**

Në çështjen juridike të:

I.I.

Drenas

Pala ankuese/Paraqitësi i kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Esma Ertezi dhe Rolandus Bruin, anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/196/2013 (lënda e regjistruara në AKP me numrin KPA00049), të datës 18 prill 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 6 Maj 2015, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e I. I.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/196/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00049), i datës 18 prill 2013.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 5 maj 2006, pala ankuese, më parë paraqitësi i kërkesës I. I., ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së pronësisë, riposedimin dhe kompenzimin për shfrytëzimin e parcelës nr. 6/12, në sipërfaqe prej 4He 0Ari 0m², Fleta Poseduese nr. 190, Zona Kadastrale Komoran, Komuna e Drenasit (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar.
2. Ai ka pretenduar se prona e kërkuar i ishte marrë atij në mënyrë diskriminuese në vitin 1961, prandaj edhe e kërkonte rikthimin e saj në bazë të aktvendimit nr. 1230.
3. Për të mbështetur pretendimet e tija pala ankuese në mes të tjerash ka paraqitur edhe këto dokumente:
 - Vendimi nr. 03-1230 i datës 10 dhjetor 1963, i nxjerrë nga Sekretariati Krahinor i Financave – Dega e Pronës Popullore në Prishtinë. Sipas këtij vendimi, vendimi tjetër nr. 1230 i datës 30 nëntor 1963 i Komisionit për Zgjidhjen e Marrëdhënjeve Pronësore që kanë lindur si pasojë e uzurpimit joligjor të pronës shoqërore të Komunës së Drenasit, është anuluar;
 - Vendimi R.nr. 860/75 i datës 10 shkurt 1976, i nxjerrë nga Gjykata Komunale e Prishtinës. Sipas këtij vendimi vërtetohet se pala ankuese ka të drejtën e banimit në banesën-garsonjerën nr. 2 në Drenas;
 - Vendimi C.nr.79/76 i datës 8 prill 1976, i nxjerrë nga Gjykata Komunale e Prishtinës. Me këtë vendim vërtetohet se pala ankuese ishte penguar në shfrytëzimin e banesës-garsonjerës nr. 2 në Drenas;
 - Kopja e planit e datës 26 janar 2001, e lëshuar nga Komuna Kadastrale Drenasit në lidhje me ngastrën parcelën nr. 754 (ndërtesë);

- Vendimi nr. 202-787 i datës 23 shtator 2002, i lëshuar nga Sektori i Ofiqarisë – Drejtoria për Administratë dhe Personel e Komunës së Drenasit. Sipas këtij dokumenti mbiemri i palës ankuese nga I. është përmirësuar në I;
 - Letër a palës ankuese datë 8 maj 2007, e adresuar Agjencionit Kosovar të pronës (AKP-së). Në këtë letër pala ankuese i kërkon AKP-së transparencë dhe vendim efektiv juridik për realizimin e kërkesës së tij;
 - Deklarata me shkrim a palës ankuese e datës 19 prill 2006, e adresuar Agjencionit Kosovar të Pronës (AKP-së);
 - Deklarata me shkrim e palës ankuese e datës 19 prill 2006, e adresuar Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM-së);
 - Letër e palës ankuese e datës 10 tetor 2008, e adresuar Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB). Në këtë shkresë pala ankuese kërkon rikthimin e së drejtës së tij banesore dhe pronësore në banesën dhe tokën e shoqëruar – truallin ndërtimor në sipërfaqe prej 0.08.ha, i tjetërsuar nga Komuna e Drenasit në vitin 1950;
 - Lista Poseduese nr. 87 (pa datë) në lidhje me parcelën nr. 754 dhe 752;
 - Deklaratë me shkrim (e padatë) adresuar Agjencionit Kosovar të Pronës; dhe
 - Leternjoftimi i palës ankuese i lëshuar me datë 8 August 2001.
4. Me 18 dhjetor 2006, Ekipi Njoftues i AKP-ës ka bërë njoftimin e pronës së kërkuar. Ndërsa sipas raportit të datës 1 korrik 2010, shihet se AKP-ja kishte bërë ri-njoftimin e pronës së kërkuar dhe konfirmimin e njoftimit në pronën e kërkuar, dhe se prona e kërkuar (Tokë/Mal) ishte gjetur e pazuruar.
 5. Pas njoftimit të pronës dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditësh askush nuk është paraqitur si palë përgjegjëse ose palë e interesuar para AKP/KKPK-ës, prandaj edhe AKP/KKPK-ja e ka trajtuar kërkesën e paraqitur si jokontestuese.
 6. Nga raportet e verifikimeve të AKP-ës të datave 6, 11 dhe 19 korrik 2007 shihet se aktvendimi nr. 03-1230 është gjetur dhe verifikuar pozitivisht, nderkaq që Fleta Poseduese nr. 120 e cila pretendohet se pasyqron të regjistruar pronën e kërkuar (ngastrën kadastrale 6/12) nuk është gjetur dhe verifikuar pozitivisht. Edhe raportet e verifikimeve te datave 9 korrik 2008 dhe 19 prill 2011 konstatojnë se prona e kërkuar si ngastër parcele 6/12 nuk është gjetur.
 7. KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/196/2013 të datës 18 prill 2013 e ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të juridiksionit. KKPK-ja ka pranuar se lënda nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999.

8. Vendimi iu dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 7 tetor 2013. Ai ka paraqitur ankesë më 6 nëntor 2013.

Pretendimet e palës ankuese:

9. Pala ankuese ka kundërshtuar vendimin e KKKP-ës duke konsideruar se vendimi është antikushtetues dhe i kundërligjshëm. Më tutje ai thekson se vendimi është mbi bazën e mashtrimeve, abuzimeve dhe shpërdorimeve të pozitive zyrtare, prandaj edhe kërkon rishikim të jashtëzakonshëm të vendimit dhe anulim të procedurave të palejuara dhe që prona e kërkuar t'i rikthehet atij.
10. Pala ankuese pretendon se prona e kërkuar i është marrë atij në vitin 1961 dhe atë në mënyrë diskriminuese dhe se mbi bazën e aktvendimit nr. 1230 ai ka të drejtën e rikthimit të pronës në emrin e tij personal.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës:

11. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (në tekstin e mëtejme Ligji 03/L-079).

Meritat:

12. Ankesa është pabazuar.
13. Sipas nenit 3.1 të Ligjit, Komision ka kompetencë që të zgjidh kërkesat lidhur me të drejtat që nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
14. Në rastin aktual, posedimi i pronës ishte humbur në vitin 1961 (vetë paraqitësi i kërkesës e pohon këtë fakt), që do të thotë se kërkesa nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999. Prandaj, Komisioni me të drejtë e ka hedhur poshtë kërkesën pasi që ajo është jashtë juridiksionit të saj.

15. Nga arsyet e paraqitura dhe në bazë të nenit 13.3 (c) të ligjit 03/L-079, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it